



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:262382

Datë: 24.03.2021

Numri i dokumentit: 01629230

A.nr.1074/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me sekretaren juridike Sanie Salihu, në konfliktin administrativ, të paditësit “A.....” ShPK me seli në S....., Rr. “B..... 123” të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. Avokat në P..... adresa I.F.A, T.D. zyra nr.5, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt kontesti – anulim vendimi vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcakëtuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat N.S., e në mungesë të palës së paditur, me datë 08.03.2021 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “A.....” ShPK me seli në S....., Rr. “B..... 123” të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. Avokat në P..... si e bazuar.
- II. ANULOHET Vendimi nr.82/2018 i datës 19.04.2018 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.

A r s y e t i m

Më 08 mars 2021, Gjykata për këtë lëndë të konfliktit administrativ, e në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale neni 81.B, i ligjit nr. 04/L-102, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, dhe neni 17, të ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit

gjqësor kryesor. Seanca e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik është mbajtur konform nenit 41 të LKA-së.

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 10.05.2018, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të ndryshohet aktvendimi i Administratës Tatimore së Kosovës në Prishtinë nr.82/2018 i datës 19.04.2018 si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia pranoj faturat blerëse me subjektet H-D me NRF ....., BI “ F.G.” me NRF ..... dhe “D.B.” SHPK me NRF ..... për periudhën 10, 11/2016. Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse si në padi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se në periudhën kontestuese asnjëri nga këto subjekte nuk ishte në listën e bizneseve jo aktive apo të atyre që i është revokuar certifikata e TVSH-së. Paditësi nuk ka pas asnjë mundësi të di apo edhe të dyshoj se këto fatura të deklaruara janë të dyshimta ashtu siç e potencon e paditura. Paditësi sa i përket këtyre faturave fillimisht ka nënshkruar kontratë e më pastaj janë lëshuar faturat, është kryer shërbimi janë paguar nëpërmjet xhirollogarisë bankare dhe mallin e blerë paditësi e ka për eksport dhe për këtë i ka të bashkangjitura edhe deklaratat eksportuese të doganës, andaj në vendimin e atakuar nuk sqarohen faktet vendimtare e as nuk janë dhënë përgjigje në pretendimet e palës paditëse kështu që ky vendim nuk ka arsyetim të mjaftueshëm dhe vendimi duhet të shpallet i paligjshëm në kuptim të nenit 52 të LKA-së. Andaj i propozojmë gjykatës që vendimin kontestues me nr.82/2018 të dt.19.04.2018 të anulohet dhe i njëjti të ndryshohet apo çështja të kthehet në rivendosje.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 13.06.2019 e konteston në tërësi pretendimet e paraqitura në padi të paditësit si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson e vendimi i departamentit të Ankesave të ATK-së nr.82/2018 është i drejtë dhe i bazuar në legjislacionin tatimor të aplikueshëm. Tutje kërkon nga gjykata që të anulohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet si i bazuar vendimi kontestues. E Paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, andaj gjykata ka proceduar tutje konform nenit 41 të LKA-se duke i lexuar parashtrirat e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 08.03.2021, ka administruar

provat dhe atë: Vendimi nr.82/18 i dt.19.04.2018, ankesa nr.05/18 e dt.05.01.18, raporti i kontrollit nr.13112 i dt.29.11.17, deklarata e D.J. e dt.03.01.18, deklarata e B.E. dt.03.01.18, Vendimi për lëshimin e gjobës 1819/17 dt.08.12.17, libri i blerjes për vitin 2016, libri i shitjes për vitin 2016, Formulari CD për periudhën e deklarimit 2016, Formulari i deklarimit të TVSH-së për periudhën e deklarimit 11/16, 7/16, 8/16, 9/16, 10/16, kërkesa për rimbursim e dt.12.04.17, Fatura nr.002/16 e dt.21.11.16, transferi bankar i Bankës NLB i dt.29.11.16 ora 14,44 dhe 27.12.16 ora 14,58, çertifikata e regjistrimit të biznesit për subjektin “D.... B.E.” e dt.31.03.16 së bashku me informatën mbi biznesin, çertifikata e TVSH-së e dt.31.03.16, kontrata mbi shitblerjen e lëkurave të freskëta të kriposura e dt.20.11.16, Fatura nr.A/27-e dt.16.11.16, DUD EX1 NR.3149 dt.16.12.16, Fatura nr.26/16 dt.16.11.16, EUR1 NR.0045085 dt.16.11.16, çertifikata veterinare e AUV dt.16.11.16, CMR Nr.2921 dt.16.11.16, Fatura nr.86-220-001-16 e dt.16.11.16, transaksionit bankar i Bankës NLB dt.16.11.16 ora 16,03, Pagesa për AUV dt.16.11.16, Fatura Nr.A/26-E e dt.09.11.16, DUD nr.30611 dt.09.11.16, Fatura nr.25/16 dt.09.11.16, çertifikata veterinare e AUV dt.09.11.16, EUR-1 NR.0045084 dt.09.11.16, CMR NR.2922 dt.09.11.16, Fatura nr.42-220-001-16 e dt.09.11.16, Pagesa e taksës për AUV e dt.09.11.16, transferi bankar në Bankën NLB dt.09.11.16 ora 13,33, Fatura nr.A/25-E dt.03.11.16, DUD NR.30078 dt.03.11.16, Fatura nr.24/16 dt.03.11.16, EUR-1 Nr.0045083 dt.03.11.16, fatura nr.12-220 – 001- 16 dt.03.11.16, CMR NR.2920 dt.03.11.16, pagesa e taksës AUV e dt.03.11.16, transaksionit bankar NLB Bankë dt.03.11.16 ora 16:16, kalkulimi nr.25 dt.14.11.16, Fatura nr.003/16 dt.14.11.16, transferi bankar NLB Bankë dt.08.12.16 ora 14,07 dhe 17.11.16, 19.11.16, Kalkulimi nr.24 dt.08.11.16, Fatura nr.002/16 dt.08.11.16, transaksioni bankar NLB dt.09.11.16 ora 13,33, 17.11.16 ora 15,28, kalkulimi nr.23 dt.01.11.16, Fatura nr.001/16 dt.01.11.16, transaksioni bankar NLB Bankë dt.05.11.16 ora 11,36, 04.11.16 ora 12,51, çertifikata e regjistrimit të biznesit për subjektin P-D dt.30.05.16, çertifikata e TVSH dt.30.05.16, Kontrata e dt.01.11.16, Fatura A/24-E dt.18.10.16, DUD Nr.28539 dt.19.10.16, Fatura nr.23/16 dt.18.10.16, EUR-1 NR.0045082 dt.19.10.16, çertifikata veterinare e AUV e dt.18.10.16, CMR NR.002212 dt.18.10.16, Fatura nr.109-10-N01-SHV01-16 dt.19.10.16, pagesa e taksës në AUV dt.18.10.16, Fatura nr.A/23-E dt.18.10.16, DUD nr.28538 dt.19.10.16, Fatura nr.22/16 e dt.18.10.16, EUR-1 NR.0045081 dt.19.10.16, çertifikata veterinare dt.18.10.16, CMR NR.002211 dt.19.10.16, Fatura nr.108-10 dt.19.10.16, pagesa e taksës në AUV e d.18.10.16, Fatura nr.A/22-E dt.11.10.16, DUD

NR.27687 dt.11.10.16, Fatura nr.22/16 dt.11.10.16, EUR-1 0036920 dt.11.10.16, çertifikata veterinare dt.11.10.16,CMR 0900020 dt.11.10.16, Fatura nr.59-10 dt.11.10.16, pagese e taksës në AUV e dt.11.10.16, Fatura nr.A/21-E dt.04.10.16, DUD nr.27015 dt.05.10.16, Fatura nr.21/16 dt.04.10.16, EUR1 NR.0036919 dt.05.10.16, çertifikata veterinare dt.04.10.16, CMR NR.090015 dt.05.10.16, Fatura nr.11-10 e dt.05.10.16, Pagesa e taksës në AUV e dt.04.10.16, kalkulimi nr.22 i dt.16.10.16, Fatura nr.004/16 dt.16.10.16, transferi bankar i Bankës NLB i dt.21.10.16 ora 10:22, 22.10.16 ora 11:09, Kalkulimi nr.21 dt.13.10.16, Fatura nr.003/16 dt.13.10.16, transaksioni bankar i Bankës NLB dt.20.10.16 ora 10,42, 21.10.16 ora 10,20, kalkulimi nr.20 dt.09.10.16, Fatura nr.002/16 dt.09.10.16, transaksioni bankar NLB Bankë dt.20.10.16, 12.10.16, kalkulimi nr.19 dt.12.10.16, Fatura nr.001/16 dt.02.10.16,Transaksioni bankar NLB dt.11.10.16 dhe 12.10.16, çertifikata e regjistrimit të biznesit për subjektin “F.G.” BI e dt.08.04.16 së bashku me informatat mbi biznesin, çertifikata e TVSH-së dt.08.04.16, kontrata e dt.02.10.16, përgjigja në padi e dt.13.06.19, gjendja e borxheve e datës së printimit 06.12.19, e-maillet e dt.12.06.19.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 08.03.2021 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, thënieve në padi, dhe raporti i kontrollit nr. 13112, i datës 29.11.2017, Gjykata konstaton se paditura ka kryer vlerësim tatimor për paditësin pas kërkesës së të njëjtit për rimbursimin e TVSH-së. Objekt i vlerësimit tatimor kanë qenë periudhat dhe llojet të tatimeve; (TVSH) Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për periudhën 09/2016 – 11/2016, (WM) Tatim të Mbajtur në Burim për periudhën 09/2016 deri 11/2016, Kontribute Pensionale (CM) 09/2016 deri 11/2016, dhe dhe Tatimi mbi Qiranë (WR) për periudhën prej 09/2016 deri 11/2016, e i cili kontroll ka rezultuar me ulje kreditimit të TVSH-së që ka ardh si rezultat i mosnjohjes së faturave blerëse të lëshuara

nga bizneset “H-D” (.....) BI “F.G.” (.....) dhe “D.B.” ShPK (.....), duke ndikuar në zvoglimin e balancës kreditore për 52,093.36€ dhe ndëshkim 25% prej 13,023.34€ sipas vlerësimit të kontrollit.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim, të metat e tilla konsistojnë në faktin se nuk janë dhënë arsye të bazuara lidhur me trajtimin e faturave të lëshuara nga subjektet H-D” (.....), BI “F.G.” (.....) dhe “D.B.” ShPK (601608568), për këtu paditësin e të konsideruara si fatura fiktive nga e paditura. E paditura në vendimin kontestues nuk e ka arsyetuar faktin se përse këto fatura janë fiktive, e njëjta nuk ka kontestuar asnjë element të faturës e as pagesat e realizuara për këto fatura në raport me këtu paditësin, por vetëm është arsyetuar me faktin se këto biznese nuk i kanë të deklaruar blerjet mbi 500€, nuk kanë importe “lekurë e freskët lope” dhe nuk kanë blerje vendore apo importe të mallit të përshkruara në faturat kontestuese. Gjykata vlerëson se në bazë të nenit 45, të Ligjit mbi TVSH nr.05/L-037 faturat e lëshuara nga këto subjekte i përmbajnë elementet që parashihen në bazë të këtij neni. Për të njëjtat fatura janë bërë pagesat nga këtu paditësi përmes xhirrollogarisë tek subjektet përkatëse të cilat pagesa janë të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe numrit të faturës. Paditësi gjithashtu këto fatura i ka të regjistruara në librat e blerjes për të cilën e paditura nuk ka dhënë asnjë vërejtje, andaj për Gjykatën një arsyetim i tillë është i mangët dhe i pa qartë dhe si i tillë është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. Gjykata vlerëson se aktvendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veq e veq dhe të ndërlidhura së bashku, andaj deomos edhe është dashur të anulohet.

Po ashtu për Gjykatën është i papranueshëm edhe arsyetimi i departamentit të ankesave pranë të paditurës se pas verifikimit të gjendjes së përgjithshme të subjekteve në fjalë “H-D” (.....), BI “F.G.” (.....) dhe “D.B.” ShPK (.....), është vërtetuar se të njëjtat, nuk i kanë të deklaruar blerjet mbi 500.00€ dhe nuk mund të identifikohen blerjet kontestuese, nuk dihen subjektet nga të cilët kanë kryer blerje etj., për arsye se për parregullësitë e konstatuara nga ATK-ja në këto biznese si palë të treta nuk mund të

mbahet përgjegjës këtu paditësi. E paditura nuk e ka bërë të njohur faktin nëse në kohën e kryerjes së këtyre transaksioneve, në web-faqen zyrtare të ATK-së kanë qenë të publikuara këto biznese si biznese jo-aktive apo që i'u është tërhequr çertifikata e TVSH-së. Nga ana tjetër ATK-ja përmes njoftimeve për tatimpagues bënë vazhdimisht thirrje që bizneset para se të kryejn transaksione me bizneset tjera të hyjnë në web-faqen e ATK-së për t'i verifikuar bizneset fiktive. Andaj kjo Gjykatë edhe njëherë ri thekson se arsyetimin e të paditurës lidhur me elementin faktik se faturat janë fiktike dhe apo subjektet me të cilat këtu paditësi ka qenë në raport kontraktues janë fiktike i konsideron tani për tani si të pa pranueshme pasi që blerësi këtu paditësi nuk mund të mbahet përgjegjës për shkelje të legjislacionit tatimor, pse shitësit këtu subjektet – palët e treta "H-D" (.....), BI "F.G." (.....) dhe "D.B" ShPK (.....), mundet që eventualisht t'i mungojë mirëbesimi dhe nëse eventualisht nuk i kanë përmbushur deklaratimet e veta tatimore, gjithmonë kur kihet parasysh fakti se ATK-ja nuk e ka bërë të njohur rrethanën nëse paraprakisht ka publikuar njoftimet se gjoja bëhet fjalë për afaristë pa mirëbesim, në mënyrë që blerësit të viheshin në dijeni me kohë për këtë gjë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata e ka të pa mundur që të vendos mbi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, për arsye se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta nga faktet të cilat janë vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, sikurse edhe e drejta materiale në këtë rast është aplikuar në mënyrë të gabuar.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur vërejtjet si më lartë, nëse faturat kontestuese i plotësojnë kushtet nga Neni 45, i Ligjit nr. 05/L -037, Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, për transaksionet bankare si dhe të deklarohet edhe për deklaratat eksportuese të këtu paditësit në referenc të mallit kontestues të dala nga faturat e subjekteve "H-D" (.....), BI "F.G." (.....) dhe "D.B." ShPK (.....), e të administruara si provë në këtë lëndë dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e kësaj të përcakëtoj saktë dhe qartë qarkullimin eventual shtesë për llojet e tatimit për periudhat kontestuese.

Ligji nr. 05/L -037 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, Neni 45, Përmbajtja e faturave të lëshuara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm, paragrafi 1. *“Personi i tatueshëm, i cili lëshon një faturë për personin e tatueshëm, në faturë duhet të paraqes të dhënat si në vijim: 1.1. datën e lëshimit; 1.2. numrin rendor që mundëson identifikimin e faturës; 1.3. numrin e regjistrimit të TVSH-së si dhe numrin fiskal të personit të tatueshëm me të cilin ai furnizon mallra ose shërbime; 1.4. numrin e regjistrimit të TVSH-së si dhe numrin fiskal të klientit apo të blerësit, nëse klienti apo blerësi është i obliguar të paguaj TVSH-në në mallrat apo shërbimet e furnizuara për të; 1.5. emrin dhe adresën e plotë të personit të tatueshëm dhe klientit apo blerësit të tij; 1.6. sasinë dhe natyrën e mallrave të furnizuara, ose nivelin dhe natyrën e shërbimeve të bëra; 1.7. datën në të cilën është bërë apo përfunduar furnizimi i mallrave ose shërbimeve, ose datën e pranimit të pagesës në llogari, përderisa ajo datë mund të përcaktohet dhe ndryshon nga data e lëshimit të faturës; 1.8. shumën e tatueshme në të cilën është ngarkuar TVSH-ja për secilën shkallë individuale, ose për të cilën aplikohen lirimet individuale, çmimi i njësisë duke përjashtuar TVSH-në për mallrat apo shërbimet dhe çdo ulje të çmimit dhe zbritje që nuk është përfshirë në çmimin e njësisë; 1.9. normën e aplikuar të TVSH-së”*.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*.

Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt

administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenin 43 par. 2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal

A.nr.1074/18, datë 08.03.2021

Sekretare Juridike

Sanie SALIHU

\_\_\_\_\_

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

\_\_\_\_\_

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.